



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

URDHËR

Nr. 73, datë 20/07 /2020

MBI

“MARRJEN E MASAVE ORGANIZATIVE PËR ZBATIMIN E URDHËRIT TË PËRBASHKËT NR. 2, DATË 02.07.2020 “PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, SI DHE NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021”, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; **Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 436, datë 3.06.2020**, Për “përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2020-2021” dhe 2021-2022 e në vijim; **Urdhri i përbashkët Nr. 2, datë 02.07.2020**, “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, si dhe në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2020-2021”; **Udhëzimit Nr. 10, datë 15.05.2019**, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar; Vendimeve të Senatit Akademik të Universitetit të Arteve si më poshtë: VSA Nr. 11, datë 07.02.2020; VSA Nr. 12, datë 07.02.2020; VSA Nr. 14, datë 07.02.2020; VSA Nr. 15, datë 07.02.2020; VSA Nr. 17, datë 07.02.2020; VSA Nr. 18, datë 07.02.2020; VSA Nr. 26, datë 08.06.2020,

U R D H Ë R O J:

1. Ngritjen e grupit të monitorimit të zhvillimit të konkurseve të pranimit, në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2020 - 2021, me përbërje si më poshtë:



- Arian Paço
 - Erald Bakalli
 - Suela Kromidha
2. Konkursët e pranimit për të gjitha programet e studimit të ofruara nga Fakultetet e UART do të zhvillohen nga data **24 Gusht 2020 deri më datën 27 Gusht 2020**.
 3. Regjistrimi i konkurrentëve për në konkursët e pranimit në programet e studimit me kohë të plotë Bachelor, në të gjitha Fakultet e UART, për të gjitha programet e studimeve të ofruara bëhet pranë sekretarive mësimore, dhe fillon në datën **17 Gusht 2020 nga ora 08:00 deri më orën 16:00**. Konkurrentët të regjistrohen deri në orarin e përcaktuar nga secili fakultet për fillimin e konkurseve të pranimit.
 4. Dokumentacioni për tu regjistruar në konkursët e pranimit është:
 - Mandati i pagesës së tarifës të konkurrimit;
 - Fotokopje të kartës së identitetit ose të pasaportës.
 5. Regjistrimi pranë sekretarive përkatëse bëhet nga vetë konkurrenti ose nga një person i autorizuar prej tij/saj, me prokurë të posaçme.
 6. Kanë të drejtë të regjistrohen për në konkursët e pranimit të gjithë kandidatët sipas listës së shkarkuar nga portali U-Albania.
 7. Sekretaritë mësimore të Fakulteteve të UART, brenda datës 06 Gusht 2020, të marrin masat për shkarkimin nga Portali U-Albania të listës së aplikantëve që konkurrojnë në programet përkatëse të studimit, afishimin e tyre në mjedisët e fakulteteve si dhe të dërgohen për tu publikuar në faqen zyrtare elektronike të UART në adresën e E-mail it@uart.edu.al.
 8. I gjithë kalendari i procedurave do të bëhet në zbatim të **Urdhrit të përbashkët Nr. 2, datë 02.07.2020**, "*Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, si dhe në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2020-2021*".
 9. Të afishohen në mjediset e secilit nga Fakultetet e UART, Urdhrat/Vendimet mbi masat e marra për konkursët e pranimit, rregulloret dhe Kriteret e konkurseve të pranimit, si dhe çdo procedurë tjetër të nevojshme mbi këtë proces.
 10. Marrjen e masave të nevojshme të të gjitha strukturave drejtuese akademike dhe administrative të UART, për distancimin social për shkak të gjendjes së fatkeqësisë



natyrore të shkaktuar nga pandemia e Covid 19.

11. Sektori i shërbimeve si dhe fakultet në UART të marrin masat e nevojshme që ditën e dielë më datë **23 Gusht 2020** të përgatisin ambjentet në të cilat do të zhvillohen konkurset e pranimit për të gjitha programet e studimit.
12. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri anëtarët e grupit të monitorimit, Dekanët e Fakulteteve të UART, Përgjegjësit e Njësive Bazë, Sekretaritë e Fakulteteve, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Sektori Mësimor, Sektori i Teknologjisë Informacionit, Sektori i Statistikë Informacionit, Sektori i Shërbimeve.
13. Të njoftohet për marrjen e masave të veçanta për administrimin dhe ruajtjen ambienteve të UART, për periudhën e konkurseve, shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike ILLYRIAN GUARD.
14. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të Web-it, të Universitetit të Arteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

REKTORI

Prof. Kastriot ÇAUSHI

UNIVERSITETI I ARTEVE